

HISTORIKU I SHKOLLËS “DRITA”NË RUBOFC

Shkolla jonë mësimet e para i filloi në vitin 1947 – në një shtëpi të improvizuar në shkollë në kushte jashtëzakonisht të vështira për punë.

Mësuesi i parë i kësaj shkolle ishte z.Abaz Sylejmani nga Prizreni i cili në atë kohë punonte me klasë të kombinuara, dhe me nxënës të moshave të ndryshme në të njejtën klasë.

Kjo shkollë deri në vitin 1956 ishte paralele e ndarë fizike e shkollës fillore “Halit Ibishi” të Babushit.

Prej vitit 1956 deri më 1965 ishte paralele e ndarë fizike e shkollës fillore “Zenel Hajdini” të Gadimes, ndërsa në vitin 1965 kjo shkollë,bëhet paralele e ndarë fizike e shkolles “Emin Duraku” Banullë-Gllogofc.

Në vitin 1966/67 nxënësit e klasës së katërt për herë të parë vazhdojnë mësimin në klasën e pestë në shkollën e Rubofcit, ndërsa klasës së gjashtë nuk i`u lejua që ta vazhdojë mësimin në Rubofc nga drejtoria e shkollës “Emin Duraku” Banullë –Gllogofc.

Në vitin 1977/78 sërish nxënësit filluan mësimin në klasën e pestë, ku mësues klase ishte Basri Rudari. Që nga ky vit nxënësit vazhdojnë mësimin deri në klasën e tetë dhe shkolla e Rubofcit bëhet tetëvjeqare e plotë, por mbetet ende paralele e ndarë fizike e shkollës “Emin Duraku” Banullë-Gllogofc.

Në vitin 1997 kjo paralele e ndarë fizike e shkollës” Emin Duraku “Banullë-Gllogofc me pëlqimin e shkollës amë dhe Ministrisë së Arsimit (LASH), shkolla e Rubofcit pavarësohet dhe emërohet “DRITA”

Nga 1997 deri në vitin 2000 drejtor shkolle emërohet Njazi Aliu.

Më 22.03.1999 mësimi ndërpritet për shkak të luftës në Kosovë dhe rifillon më 01.09.1999. Në vitin 2000 z. Beqir Murati rizgjedhet drejtor shkolle nga DKA i cili udhëheq shkollën deri më 01.04 2010.

Gjatë mandatit të z. Muratit ndërtohet një shkollë në fshatin Kojskë në vitin 2001 ku shkollës amë “Drita” në Rubofc i shtohet kjo paralele e ndarë fizike.

Pas datës 01.04.2010 emërohet drejtor Njazi Aliu i cili qëndron deri më 01.04.2014. Më pas, drejtor shkolle DKA e emëron Ekrem Muratin .

Me kërkesën e drejtorit të tanishëm pranë DKA-së për ndërtimin e një shkolle të re, u vu gurëthemeli në vitin 2017. Ndersa me 14 shtator 2020 me prezencen e kryetarit të komunës Imri Ahmeti , drejtoreshes së DKA-së Elmaze Behluli si dhe shumë musafirve të tjerë në masa sigurie nga Covid -19 u bë perurimi i këti tempulli diturie.